

Nr. 2435/10 Prot.

Durrës, më 24.10.2025

V E N D I M

Nr. 122, datë 24.10.2025

PËR

"MIRATIMIN E FORMATIT TË DIPLOMËS PËR PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, MASTER PROFESIONAL NË "MENAXHIM I SIPËRMARRJEVE TURISTIKE", TË FAKULTETIT TË BIZNESIT, UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; në Udhëzimin Nr.10, datë 30.02.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" i ndryshuar me Udhëzimin Nr.14, datë 21.06.2022 dhe Udhëzimin Nr.19, datë 31.08.2023; në Urdhërin e MAS Nr. 528, datë 09.09.2022 "Për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Menaxhim i Sipërmarrjeve Turistike", në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës"; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; si dhe referuar relacionit Nr. 1161/3 prot., datë 21.10.2025 të Drejtorisë së Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave, në mbledhjen e datës 24.10.2025, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e formatit të diplomës për programin e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në "Menaxhim i Sipërmarrjeve Turistike", të Fakultetit të Biznesit, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim t'i përcillet Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesi i Njësisë Kryesore i Fakultetit të Biznesit
 - Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

